



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**  
**Komisioni për Ekonominë dhe Financat**

**RAPORT**

**PËR DEKRETIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS “PËR KTHIMIN E  
LIGJIT NR.9713, DATË 16.04.2007 “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN  
NR.8560, DATË 22.12.1999 “PËR PROCEDURAT TATIMORE NË  
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në mbledhjen e datës 11.06.2007, në mbështetje të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit, mori në shqyrtim dekretin e Presidentit të Republikës “Për kthimin e ligjit nr.9713, datë 16.04.2007 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Komisioni diskutoi rreth çështjeve të ngritura nga Presidenti i Republikës në relacionin për motivimin e kthimit të ligjit.

Në relacionin e tij Presidenti i Republikës shprehet se arsyeja e mosdekretimit të ligjit nr.9713, datë 16.04.2007 lidhet me paragrafin e dytë të nenit 43 të këtij ligji, në të cilin vendoset detyrimi që: “Para se të paraqiten për shqyrtim gjyqësor, tatimpaguesit janë të detyruar të paguajnë 15 për qind të cdo gjobe dhe interesi. Shqyrtimi gjyqësor i çështjeve zhvillohet sipas një procedure gjyqësore të përshpejtuar, e cila nuk duhet t’i kalojë 60 ditë.”

Ky rregullim, sipas vlerësimeve të Presidentit, bie ndesh me disa dispozita kushtetuese: me nenin 11, që lidhet me parimin se sistemi ekonomik në Republikën e Shqipërisë bazohet në ekonominë e tregut dhe se prona private mbrohet njëjloj me ligj; me nenin 42, që bën fjalë për garancitë për të mos cenuar liritë dhe të drejtat e njohura në Kushtetutë pa një proces të rregullt ligjor dhe me nenin 81, i cili përcakton ligjet që miratohen me shumicë të cilësuar të numrit të deputetëve.

**Mendimi i shumicës në Komision:**

Nga ballafaqimi i paragrafit të dytë të nenit 43 të ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” me nenet e sipërcituara të Kushtetutës dhe dokumente të tjera suportuese, shumica në Komision vëren se:

Kjo dispozitë, në thelb, synon të mbrojë interesat e ligjshme të ekonomisë së tregut, pronën private e publike nga shkelja e ligjit, të kufizojë informalitetin dhe evazionin

pozitë të privilegjuar ndaj sipërmarrësve të tjerë. Në këtë kuptim, ai është në përputhje me frymën e neneve 11 dhe 42 të Kushtetutës.

Një praktikë e ngjashme është ligjruar në Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë që në vitin 1999. Në pikën 3 të nenit 289 të këtij Kodi thuhet: “Për të paraqitur ankesën (në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (shënimi ynë)) apeluesi duhet të paguajë shumën e përgjithshme të detyrimeve doganore që duhen paguar dhe të depozitojë paraprakisht në llogarinë bankare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave një shumë të barabartë me 40 për qind të shumës së përgjithshme të gjobës së zbatuar nga autoritet doganore.”

Në pikën 5 të po këtij neni vazhdohet: “Nëse ankesa nuk pranohet, apeluesi duhet të paguajë pjesën që mbetet prej 60 për qind të gjobës dhe mund të ankohet kundër vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm pranë autoriteteve gjyqësore brenda 30 ditësh nga data e njoftimit të mospranimit të ankesës.”

Kodi Doganor, i cili është gjetur në përputhje me Kushtetutën, kërkon që para ankimit në gjykatë, tatimpaguesi duhet të paguajë detyrimin tatimor dhe të gjithë gjobën e vënë ndaj tij. Paragrafi i dytë i nenit 43 të ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” ka kërkesa të së njëjtës natyrë me dispozitat e sipërcituara të Kodit Doganor, me ndryshimin që, në vend të kërkesës për të paguar 100% të gjobës, kërkon pagimin vetëm të 15 % të saj.

Shumica në Komision, në arsyetimin e saj, iu referua vendimit Nr.9, datë 2.4.2003 të Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga Gjykata e Lartë në datën 11.09.2002 për shfuqizimin e nenit 43/1 të ligjit “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i cili trajton të njëjtat procedura për pagimin e tatimit mbi vlerën e shtuar.

Gjykata Kushtetuese e rrëzon ankesën me argumentin që: “e drejta e ankimit (sipas nenit 13 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut) presupozon të drejtën e qytetarit për t’iu drejtuar një organi më të lartë shtetëror, pranimin e ankimit, ekzistencën e organit për shqyrtimin e ankimit, afatet optimale të shqyrtimit, shqyrtimin objektiv, kontrollin gjyqësor, si kontrollin përfundimtar ndaj ankimit dhe një garanci për një rehabilitim të mundshëm, si pasojë e shqyrtimit dhe e pranimit të ankimit.”

Gjykata Kushtetuese, në konkluzionet e saj, shprehet se neni 43/1 i ligjit “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” nuk cenon parimin kushtetues të përpjestimit midis kufizimit që i bëhet ankimit të subjektit të tatuar me gjendjen që e ka diktuar atë masë. Kufizimi i ankimit është i përligjur dhe në përputhje me nenin 1, paragrafi 2 i Protokollit 1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, që u jep të drejtë shteteve “të venë në fuqi ligjet që i quajnë të domosdoshme për të siguruar pagesën e taksave ose të kontributeve të tjera ose të gjobave”.

Në mbështetje të qëndrimit të saj, shumica në Komision mori për bazë edhe praktikën ndërkombëtare në lidhje me këtë çështje. Në Kodin Bazë Botëror të Taksave të OECD-së, seksioni 573, pika f, thuhet se kryerja e pagesave mund të kërkohej gjatë ankimit në apel. Rregullat mund të përcaktojnë që ankimi në apel nuk mund të bëhet, përderisa një

pjesë ose i gjithë detyrimi fiskal të jetë paguar. Në seksionin 574, pika g, thuhet se gjobat, sipas përcaktimit të këtij seksioni, seksionit 563 ose seksioneve të tjera të këtij Kodi, duhet të paguhet me njoftimin dhe kërkesën e administratës tatimore dhe do të vlerësohen dhe mbledhen në të njëjtën mënyrë si edhe taksat. Çdo qëndrim në këtë Kod në lidhje me taksat aplikohet edhe për gjobat.

Bazuar në argumentet e përmendura më lart, shumica në Komision është e mendimit se paragrafi i dytë i nenit 43 të ligjit nuk bie në kundërshtim me nenet 11 dhe 42 të Kushtetutës.

Në lidhje me pretendimet për papajtueshmërinë e kësaj dispozite të ligjit me nenin 81 të Kushtetutës, shumica në Komision vëren se:

Arsyetimi se ky nen përcakton rregulla për procedimin në gjykatë të ndryshme nga ato të Kodit aktual të Procedurave Administrative, nuk qëndron. Kodi i Procedurave Administrative përcakton procedurat administrative për shqyrtimin e ankimit, ndërsa procedurat e shqyrtimit gjyqësor të ankimit administrativ përcaktohen në Kodin e Procedurës Civile.

Në nenin 145 të Kodit të Procedurës Civile përcaktohet që “Afatet për kryerjen e veprimeve procedurale caktohen nga ligji dhe kur ky e lejon, edhe nga gjykata”. Në të gjitha rastet kur ligji nuk ka përcaktuar afate, neni 327 i këtij Kodi përcakton afatin standard për gjykimin ndaj ankimit administrativ prej 30 ditësh.

Bazuar në dispozitën e përmendur më lart, shumica në Komision është e mendimit se afati prej 60 ditësh për shqyrtimin e ankimit në gjykatë, i përcaktuar në paragrafin e dytë të nenit 43 të ligjit nr.9713, datë 16.04.2007, nuk është në kundërshtim me Kodin e Procedurës Civile dhe me nenin 81 të Kushtetutës.

### **Mendimi i pakicës:**

Deputetët e opozitës u shprehën dakord me argumentet e Presidentit të Republikës për kundërshtitë e paragrafit të dytë të nenit 43 të ligjit nr.9713, datë 16.4.2007 me nenet 11, 42 dhe 81 të Kushtetutës, për shkak se:

- subjektet tatimore që paraqesin ankim në gjykatë detyrohen të parapaguajnë gjobën pa një vendim të formës së prerë të gjykatës, që vërteton se ato kanë shkelur ligjin;
- parapagimi i gjobës nga disa subjekte tatimore i vendos ato në pozita disfavorizuese në krahasim me subjektet e tjera dhe prish rregullat e ekonomisë së tregut;
- ndryshimi i afatit për përfundimin e shqyrtimit gjyqësor nga 30 ditë, të parashikuar në Kodin e Procedurave Administrative, në 60 ditë, bëhet me një ligj të miratuar me shumicë të thjeshtë votash, ndërkohë që Kodi i Procedurave Administrative është miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit dhe ka përparësi ndaj një ligji të thjeshtë.

Sipas tyre, kjo dispozitë e ligjit u pret rrugën subjekteve tatimore për t'u ankuar në gjykatë, sepse parapagimi i gjobës i ve ato në vështirësi financiare, madje shumë prej tyre i çon drejt falimentimit. Nga ana tjetër, ata theksuan se kjo dispozitë i hap rrugën abuzimeve të nëpunësve të administratës tatimore në përcaktimin e vlerësimit tatimor dhe vendosjen e gjobave.

Gjatë diskutimeve në Komision u sugjerua që të unifikohen afatet e shqyrtimit në gjykatë të ankimit ndaj aktit administrativ. Duke qenë se afati për shqyrtimin e ankimimeve me të njëjtën natyrë në Kodin Doganor është 30 ditë, mendimi i Komisionit është që, në paragrafin e dytë të nenit 43, të ndryshohet afati nga 60 ditë, në 30 ditë.

**Dekreti i Presidentit nuk u miratua me 6 vota kundër dhe 3 vota pro.** Komisioni sugjeron që në pikën 2 të nenit 43 të ligjit të bëhen këto ndryshime:

- Fjalja e dytë të ndryshohet si më poshtë:


“Shqyrtimi gjyqësor i çështjeve zhvillohet sipas një procedure gjyqësore të përsheptuar, e cila nuk duhet t'i kalojë 30 ditë nga data e regjistrimit të kërkesës në gjykatë.”

- Në fund të pikës 2 të shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Nëpunësit tatimorë, për të cilët vërtetohet se kanë llogaritur detyrimin tatimor dhe kanë vendosur gjoba në mënyrë arbitrare, ndëshkohen sipas masave ndëshkimore të përcaktuara me vendim të Keshillit të Ministrave”.

Tiranë, më 11.6.2007

K R Y E T A R I  
Edmond SPAHO





**Republika e Shqipërisë**  
**Kuvendi**  
**Komisioni për Ekonominë dhe Financat**

Dokument parlamentar

**PROCESVERBAL**  
(datë 11.6.2007, ora 10.00-11.40)

**Drejton mbledhjen:**  
**Edmond SPAHO – KRYETAR KOMISIONI**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit të datës 28 maj 2007.
2. Dekret nr.5288, datë 8.5.2007, “Për kthimin e ligjit nr.9713, datë 16.4.2007, “Për disa ndryshime në ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

**Marrin pjesë:**

Edmond Spaho Arben Malaj, Blerim Çela, Aleksandër Biberaj, Rahim Kaleci, Ndue Shpani, Albert Faruku, Angjelina Kola, Durim Hushi, Erion Braçe, Durim Lamaj.

**Mungojnë:**

Astrit Bushati, Bujar Leskaj, Petrit Gjoni, Dritan Prifti, Andis Harasani, Shpëtim Idrizi.

**Të ftuar:**

Florion Mima, zëvendësministër i Financave.

**HAPET MBLEDHJA**

**EDMOND SPAHO** – Sot do të diskutojmë rreth çështjeve që ka ngritur Presidenti në dekretin për kthimin e ligjit “Për procedurat tatimore”. Përpara se të fillojmë, sugjeroj të dëgjojmë opinionin e Ministrisë së Financave.

**FLORION MIMA** - Të nderuar deputetë!

Gjatë kohës që projektligji ishte në procedurë miratimi këtu, ne u vizitua nga një mision i FMN dhe patëm një mbledhje tjetër, me grupet e punës të departamentit teknik të BE-së. Mendimet e FMN-së dhe të BE-së në këtë pike, konvergojnë. Të dyja palët pranojnë që situata ekzistuese, në lidhje me krijimin e borxheve tatimore, është e papranueshme, është rrjedhojë e ligjit ekzistues dhe sugjerojnë të bëhen amendimet përkatëse në të mirë të zbatimit të ligjit, në mbrojtje të tatimpaguesve, por dhe të qeverisë për të gjeneruar të ardhura.

Qëndrimi i FMN-së është tejet më i ashpër se ai në ligj, thotë që administrata tatimore të nesërmen, të mbledhë me forcë të gjitha detyrimet. Pra nëse kemi ose jo ankim administrative, administrata ka në dorë të mbyllë aktivitetin dhe më tej të sekuestrojë. E mirëpritëm këtë qëndrim të FMN-së.

Edhe FMN-së kërkon që para ankimit në gjykatë, shteti të mbledhë detyrimet. I vetmi gabim është ajo e pagesës vullnetare nga tatimpaguesit, kurse ata thonë mbledhje me forcë. Për kushtet tona menduam që kjo linjë është e papranueshme.

**ARBEN MALAJ** – S'ka nevojë të sakrifikoheni kaq shumë! Ju reflektoni, por jo deri në këtë pikë! Ju duhet të jeni profesional kur flisni! Të jetë më korrekt.

**FLORION MIMA** - Unë kam detyrimin t'ju bëj me dije qëndrimin e këtyre dy trupave.

**DURIM LAMAJ** – Këto pretendime që ngrihen nga Presidenti, që shkelet Kushtetuta, qëndrojnë apo jo? Në përputhje me vërejtjet e tij, çfarë opsionesh na servirni?

**EDMOND SPAHO** – Ky është thelbi i asaj që duam të dimë. Si e gjykoni ju dekretin e Presidentit, vecanërisht tre pikat në lidhje me shkeljen e neneve të Kushtetutës? Donim një mendim.

**FLORION MIMA** - Kem diskutuar me juristët tanë. Edhe pse s'na lejohet të komentojmë, sepse stafi i tij i ka dhënë arsyet, ato argumenta nuk qëndrojnë. S'kemi të bëjmë me shkelje të Kushtetutës. Në të kundërt, projektligji garanton të mirën dhe mbron interesin e gjithë shqiptarëve, ndryshe nga ai, që ofron mbrojtje për një grup tatimpaguesish 'mëkatarë'.

**ARBEN MALAJ** – Ky është diskutim i gjatë në publik. Qeveria tha për nevojë transparence dhe u kujtua vetëm pas kërkesës të tyre për takim. Edhe dekreti ofron një mundësi për t'i dhënë trasparencë. S'është problem ideja janë ankuar disa tatimpagues 'mëkatarë'. Nëse të gjithë janë 'mëkatarë' do të thotë dicka më shumë për qeverinë. S'bie dakord me Zëvendësministrin, që përdor referencë për BE-në. Përsa i përket politikës fiskale s'ka arritur të imponojë gjë, por vetëm politika monetare. Qeverisa s'është në gjëndje, që në dokumentin zyrtar të vërtetojë sa është borxhi, sa janë interesa, sa kanë ardhur nga kompanitë publike, sa sektori privat, cilat janë tendencat, etj. Në këtë aspekt, duhet shfrytëzuar kjo mundësi për të bërë një ekspertizë më të plotë dhe të gjenden të gjitha eksperiencat, se eksperiencat në BE s'janë unike, secili vend zgjedh në përputhje me situatën e tij.

Shqetësimi për abuzivitet, vjen nga veprimet administratës fiskale. Do të hiqni gjithë ata punonjës me eksperiencë dhe do të merrni njerëzit tuaj. Kjo kërkon transparencë në komision. Nëse doni me shkrim, ju bëjmë një letër. Ju e pasqyroni me shumë suportiv që po bëhet dicka shumë e mirë me policinë tatimore. Debati për të ka mbetur 5 vjet këtu, se nga shifrat e FMN-së, ideja ishte: "Është mirë të ndryshohej". S'u kalua ligji, se po të ndodhte ishte detyra prioritare për të rënë dakord. Rruga që po ndiqni s'do na çojë në 1996, ku institucionet ndërkombëtare ju detyruan ta shpërbëni policinë tatimore.

E parë në gjithë kontekstin e saj, s'po bëhem pjesë e të drejtës të Presidentit për ta kthyer, ai ka ekspertët e tij. Jo rastësisht votimi në Parlament kërkon që mos shprehet një shumicë e thjeshtë për të. E kemi takuar presidentit me z. Spaho.

S'kam ndonjë kundërshtim se ajo do të shkojë për të mbyllur aktivitete. I vetmi shqetësim është, që edhe pse kam pyetur, është mirë të ndajmë pjesën e atributit që i japim administratës fiskale, me atributin kushtetues që ka të drejtë cdo qytetar të ankohet. Ju mund të veproni si administratë tatimore të vini gjobën, të bëni c'të doni ju. Është filozofia juaj, po e drejta kushtetuese e cdo qytetari që të ankohet në proces gjyqësor, s'mund të hiqet. Ai qytetar, po atë ditë ka të drejtë të shkojë në gjykatë, të kërkojë ndoshta prezumimin e vendimeve.

Të ndajmë dy hallkat e funksionimit të një shteti administrata dhe gjyqësori. I jepni c'të doni administratës tuaj, po hiqni nga ligji cënimin e të drejtës kushtetuese të cdo qytetari, të shkojë të ankohet. Do të na çojë deri në Strasburg dhe do të shikoni që jeni duke shkelur parimet. Ky është ligj i thjeshtë. Mos e cënioni të drejtën kushtetuese të cdo qytetari të ankohet, duke i vendosur klauzola. Nëse i ai s'i paguan detyrimet, ik sekuestro, po ai shkon në gjykatë.

Po të bëjmë debat me njëri-tjetrin, unë mendoj që është mirë garancia. Ajo është pjesë e politikës tuaj fiskale.

Ndahem në koncept me ankesën në gjyqësor. Ju e keni parashikuar këtu dhe u kthye në pazar vulgar, dhe ishte injoruese për Parlamentin dhe tregon që s'ka asnjë reference, po moment kompromisesh, për të ruajtur koalicionin. Pra, ka dicka që nuk shkon dhe qëndrimi jonë është për politikën tuaj fiskale. Mbani parasysh që një proces gjyqësor shkon gjatë. Të gjitha politikat tuaja do të shterojnë si politika, nëse nuk tregoni profesionalizëm dhe qëndrueshmëri të administratës fiskale.

**EDMOND SPAHO** - Duke ngelur në kuadrin e Rregullores së Kuvendit, i referohem pikave të cilat ka ngritur Presidenti. Neni 43, paragrafi 2, për pagimin e gjobave dhe interesave. Sipas gjykimit të tyre bie në kundërshtim me Kushtetutën.

Për të qënë të qartë, po citoj nenin 11 të Kushtetutës. Kemi garantim si të ekonomisë, pronës private dhe publike, pasi bëhet fjalë për të kufizuar praktika të parregullta, të jashtëligjshme që vendosin në pozitë të privilegjuar një kategori tatimpaguesish ndaj të tjerëve, të cilët shlyejnë detyrimet tatimore, në përputhje me ligjin. Në këtë kuptim, penalizmi i kësaj kategorie ka të bëjë me formimin e sistemit të ekonomisë së tregut të lirë dhe mbrojtje të pronës private, dhe publike. Neni 11 i kushtetutës përcakton se kufizime të kësaj veprimtarie mund të bëhen për arsye të rëndësishme dhe me ligj.

Neni 42 i Kushtetutës. Pyetja shtrohet, a preket e drejta e qytetarit t'i drejtohet gjykatës dhe të ketë të drejtën e një procesi të rregullt? Po i referohem dhe e kemi cituar dhe më pare, vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Ka një ankim në atë kohë, për të shpallur të pavlefshme dispozitë në ligjin "Për tvsh-në". Ai është në përputhje me nenin 43 të kodit të procedurave tatimore dhe kërkohet që apeluesit, të paguajnë të gjithë detyrimet e tvsh-së. Është bërë një ankim dhe Gjykata Kushtetuese ka dhënë vendimin në 2003. Asnjë nga këta elementë nuk i preket.

Shtrohet pyetja a i tejkalon të drejtat kushtetuese dhe të drejtat që i jep Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut? Gjykata thotë që nuk përbën kufizim që i tejkalon të drejtën kushtetuese dhe më tepër thotë që kufizimi është i përligjur, dhe përputhet me konventë europiane, që i jep të drejtë shteteve. Mendoj që ligji për procedurat tatimore nuk e shkel nenet, 11 dhe 42 të Kushtetutës.

Do ju citoj një rast nga praktika jonë e sistemit doganor. Neni 289 i Kodit Doganor. Për t'u ankuar në Drejtorinë e Doganave, hapi i parë paguhet i gjithë detyrimi doganor dhe 40% e gjobës. Pra, s'mund të bëhet ankim administrativ pa to. Më pas, ligji thotë që nëse ankesa nuk pranohet, apeluesi duhet të paguajë pjesën që mbetet prej 60% të gjobës dhe mund të ankohet në gjykatë, brenda 30 ditësh nga data. Në Kodin Doganor citohet që mund të shkosh për t'u ankuar në gjykatë, nëse ke paguar detyrimin tatimor dhe 100% të gjobës. Kjo klauzolë është e datës 27 janar dhe s'është gjetur antikushtetuese. Përderisa Kodi Doganor, që ka marrë 2/3 e votave s'është antikueshtuets, edhe ky ligj s'ka si të jetë antikushtetues!

Do t'i referohesha për ilustrim edhe faktit që kjo praktikë është në përputhje me praktikat ndërkombëtare në sistemin fiskal. Është seksioni 573 i Kodit të Taksave të OECD-së. Edhe nga praktika ndërkombëtare për mbledhjen e taksave dhe gjobave, apo të cdo ngarkese shtesë në detyrimin fiskal, është në përputhje me ligjin e procedurave tatimore si dhe me Kushtetutën, dhe me qëndrimin që ka mbajtur Gjykata Kushtetuese për rastin analog, për tvsh-në.

Përsa i takon neneve 11 dhe 42, mendoj që ka përputhshmëri me Kushtetutën.

Tani shohim nenin 81 të Kushtetutës. Në këtë rast ka lapsus, pasi Kodi i Procedurave Administrative trajton rregullat për gjykim administrative, jo në sistemin gjyqësor. Është Kodi i Procedurave Civile që përcakton rregullat si shqyrtohet një ankim në sistemin gjyqësor. Nëse do t'i referohemi Kodit të Procedurave Civile, do të shohim që ka dy nene që trajtojnë këtë çështje,

neni 145 dhe 327. *I citon.* Është ligj i thjeshtë dhe gjykata cakton kryerjen e veprimitarive procedurale. Në nenin 327 përcaktohet afati standard, për shqyrtimin e ankimit në gjykatë, kur ligji s'ka të trajtuar specifikisht afatin. Me një akt administrativ shqyrtohet. *Citon.*

Sipas mendimit tim, në këtë rast, në përputhje me nenin 145, ligji ka përcaktuar afat specifik për shqyrtimin e ankimit, që është 60 ditë dhe është në përputhje me Kodin Civil, pra dhe me nenin 81 të Kushtetutës. S'kemi të bëjmë me ligj organik, se edhe ligji organik ja jepte të drejtën organit propozues, Këshillit të Ministrave, që nëpërmjet ligjit të vendos afate për shqyrtim në sistemin gjyqësor.

Sugjeroj të kemi unifikim të afateve për shqyrtimin e ankimeve në sistemin gjyqësor. E kemi 30 ditë në sistemin doganor, 30 në Kodin Civil dhe në këtë rast, sugjeroj të jetë 30 ditë. Më tepër, sugjeroj që t'i vëmë kufi abuzimeve nga administrata tatimore, në aplikimin e paragrafit 2 të nenit 43. Në të gjitha rastet kur vërehet arbitraritet nga punonjësit tatimorë, të penalizohen në përputhje me disa penalitete dhe të jenë atribut i Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Financave.

**DURIM LAMAJ** – S'jam aq specialist sa të jap mendime mbi ato që thotë Presidenti, por do të përqëndrohem te disa probleme teknike. S'mund të krahasojmë Kodin Doganor me procedurat tatimore. Edhe Zëvendësministri e di që janë tjetër gjë. Kodi Doganor dhe penalizimet që bëhen në dogana, janë që bëhen në kushtet e flagrancës dhe është një vendim që është vërtetuar. Në tatime, penalizimet kanë formë tjetër, që duhet ta dini. Kemi penalizime me aktkontrolle dhe me sistemet e vlerësimit, që nga zyrat e inspektorëve tatimorë, ku vlerësimet tatimore me kalimin e kohës, mund të apelohej nga subjekti dhe gjatë apelimit, mund të shihet që ky vlerësim mund të mos ekzistojë dhe subjekti penalizohet me aq sa i takon. Në kushtet e tatimeve, edhe vetë aktkontrolli ka funksionin e një vlerësimi tatimor dhe s'ka penalizim përfundimtar, se subjekti ka të drejtë të ankohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe në shkallë të tjera. Duke qënë që në tatime ka një specifikë dhe nxjerrja e detyrimeve financiare për subjekt le shteg për abuzime nga administrata tatimore, duke qënë që në kushtet e tanishme që administrata është e politizuar dhe në shumicën e rasteve vepron me urdhëra politikë, s'mund të pranojmë që ky ligj që kthehet, të mos shqyrtohet fare nga Ministria e Financave. Të paktën sot, të vinte me opsion të vecantë!

E kam theksuar më pare, që në kuadrin e përmirësimit të klimës me biznesin, s'do të isha dakord të hiqej garancia nëpërmjet bankës. Minimalisht nëpërmjet garancisë bankare të vazhdojnë procedurat. Po gjatë këtij shqyrtimi, gjithcka është formale dhe nga përgjigja e Zëvendësministrit, që: "S'kemi asgjë për të thënë".

Për të përmirësuar klimën me biznesin, sidomos në Komisionin e Ekonomisë, minimalisht duhet të futet garancia bankare. Do të ishte një hap që i jep biznesit një hapësirë tjetër. Në rast se nuk sjellim asgjë të re edhe tani, mendoj që edhe personalisht s'jam i gatshëm të vazhdoj diskutimin.

**ANGJELINA KOLA** - Dekreti e ka vlerësuar i projektligjin që sjell disa rregullime më të mira, po ky rregullim ka rënë ndesh me disa dispozita të Kushtetutës. Themi që ai ka dhënë një interpretim juridik të këtyre neneve dhe unë si ekonomiste mendoj që nuk do të jem më në gjendje se këta juristë, për këtë vlerësim. Përderisa nga ana e qeverisë nuk ka asgjë të re, do të votoj pro.

**BLERIM CELA** - Në pamje të parë, po të shohësh argumentin e Presidentit, të mbushet mendja se ka të drejtë. Po nëse do të shohim nenet, si i argumenton z. Spaho, rezulton se ligji është në rregull dhe jam i mendimit të mos miratohet dekreti i Presidentit. Përveç atyre, them që juristët i shohin këto probleme me dy standarde: sipas nenit 289 të Kodit Doganor lejohet që



apeluesi të paguajë 40% të gjobës para apelimit dhe kjo quhet e rregullt, ndërsa me këtë ligj po të paguajë 15%, është antikushtetuese, kur ka dhe vendim të Gjykatës Kushtetuese që është në mbështetje të plotë të asaj që kemi miratuar, duke marrë analogji që ai është apeluar në 2003 dhe Gjykata Kushtetuese e ka pranuar pagesën e gjobës.

Ne s' duhet t'i shohim këto probleme me dy standarde! Kaq e gjykoji ligjvënësi 15%. Dhe aq më tepër, si tha z. Mima, ky ligj është parë me FMN-në dhe BE-në, të cilët pranojnë se jemi brenda standardeve evropiane. Ky ligj do të rregullojë arkëtimin shpejtë të debitorëve, që përbëjnë jo më pak se 400mln euro, që rëndon mbi ekonominë shqiptare. Ky ligj do të luftojë bizneset e parregullta dhe do të mbrojë ato të rregulta. Këto para do të shkojnë në dobi të ekonomisë, të rritjes së pensioneve, të rrogave të ulëta etj. Jam kundër dekretit. Ne nuk kemi gjë me biznesin e ndershëm, atë e ndihmojmë, por ndëshkojmë informalitetin.

**FLORION MIMA** - I dëgjova propozimet në lidhje me shkurtrimin e periudhës së gjykimit dhe unifikimin me procedura të ngjashme. Jemi dakord dhe mbështes dhe iniciativën tuaj, për të prezantuar masa ndëshkuese për inspektorët tatimorë, që tejkalojnë detyrën. Jemi dakord që Këshilli i Ministrave të nxjerrë një akt, ku do të specifikohen të gjitha shkeljet.

Është referencë e gabuar, për shkelje në kushtet e garancive s' është e vërtetë. Sot shumica e shkeljeve ndodhin mbas ngjarjeve dhe s' ka bazë referenca, dhe krahasimi i tij.

**EDMOND SPAHO** - Cështja e dëmshpërblimit të tatimpaguesit pas marrjes së vendimit gjyqësor, supozoj se është në rastin kur organi tatimor ka vepruar në mënyrë të parregullt dhe ka gjobitur gabim. Në këtë rast dëmshpërblimi i tij është caktuar në nenin tjetër, është e siguar me ligj shumica e kthimit e gjobës dhe interesat që janë mbajtur. Rregullimi që duam të bëjmë me disiplinimin e administratës tatimore kur vepron në mënyrë arbitrare, në të gjitha këto ngjarje, duhet të kthehet detyrimi tatimor, po dhe të disiplinohet administrata.

Garancia. Në fakt, garancia s' është element i ri, ne e kishim. Neni 43, 2, ka hequr dhe garancinë nga përdorimi, sepse praktika e gjithë viteve kur u vendos, tregoi që nuk arrihet të mblidhet detyrimi tatimor dhe gjobat, dhe një nga arsytet që është krijuar ky detyrim prej 400 mln lekë, është ekzistenca e një përcaktimi të tillë në ligjin fiskal e cila asnjëherë nuk bëhet funksionale për organin tatimor.

**ERJON BRAÇE** - Dekretin e shoh si mundësi jo thjesht pune për ne, se ne do të ishim më pak të interesuar se s' kemi votat, më tepër e shoh si mundësi për ju. Ju mund të keni konflikt kushtetues me ne se po mbrojmë të drejtën kushtetuese të pafajësisë këtu dhe jashtë, po e keni konfliktin me grupet e biznesit, që janë pala e interesuar drejtpërdrejt për këtë cështje. S' jemi ne tatimpaguesit në konflikt me ju. Janë totalisht të gjithë pa përjashtim, klientë të ish-qeverisë socialiste apo tuajit, që janë kundër aplikimit të kësaj mase, që e quajnë repressive dhe jo vetëm para miratimit të ligjit, por dhe pas, që ju duhet të hyni në konsultime me ta, për të bindur që ta pranoni këtë cështje. Edhe Presidenti s' është mbështetur vetëm te Kushtetuta, por dhe të kontestimet masive të gjithë komunitetit të biznesit dhe nga ana juaj s' ka asnjë reflektim.

Së dyti, mund t'i pranoj të gjithë arsyetimin tuaj për kushtetueshmërinë, po ky është debat i bërë këtu me argumentet tuaja, tonat dhe të biznesit. Është debat që nuk shteron kurrë, pavarësisht argumentat që sillni sot, që janë të njëjta, pavarësisht kundërshtimet që sjellim këtu, që janë përsëritur edhe tek dekreti, që mbetet Gjykata Kushtetuese. Mesa shikoj unë, këtë ligj nuk e zbatuat dot këto tre muaj, për pikësynimin që kishit për të luftuar informalitetin dhe do të jetë kështu, përderisa këto grupe biznesi do t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese, për kushtetueshmërinë e tij. Pra, rruga e mosreflektimit të realizimit të qëllimit tuaj, do t'ju shtyjë në kohë, për të mos aplikuar këto masa që doni të ndërmerri, të të luftuarit të evazionit fiskal, se Gjykata Kushtetuese do të jetë pjesë e vlerësimit të kushtetueshmërisë së tij.

Mendoja që do të reflektoni duke e parë situatën ekonomike të vendit, marrëdhëniet me biznesin apo një sërë ligjesh represive kundër tij. Ky ishte i pari, i dyti ishte për pagat referuese, i treti po vjen duke u referuar në nenin e Kodit të Procedurave Tatimore, ligji për të ardhurat personale, për personat juridikë dhe deklarat e zëvendësministrit të ekonomisë, që pjesa më e madhe e biznesit kanë plotësuar kriteret që parashikon ligji për falimentimet.

Së katërti, duam të kemi shifra. Thoni është 400 mln borxhi. Përtej kësaj, këtu kanë pjesë edhe ndërmarrjet aksionere, do të donim një shifër sa janë bizneset që janë penalizuar në Shqipëri. Nga një e dhënë e tillë, mund të fillonim të arsyetonim, janë penalitete të drejta apo që vijnë për të mbushur arkën e shtetit në mënyrë abuzive?

Jam dakord të pranohen propozimet tuaja për shkurtim dhe penalitete, por c`vlerë ka kjo? Nëse një tatimor ka vendosur gjobën, me ligj duhet të shkojë në gjykatë dhe të paguajë edhe gjobën, dhe në fund të kem humbur dhe biznesin, c`vlerë ka nëse do të hiqet nga puna ai tatimor, që mori këtë vendim arbitrar?! Shembujt tregojnë që s`është punë vlerësimi tatimor, që këto veprime nuk kryhen nga një tatimor, por me urdhër dhe ky është problemi i rradhës, akoma më i madh. Natyrisht që edhe unë si kolegët e tjerë, do të votojmë pro dekretit, për t`i dhënë mundësi edhe seancës për reflektim. Jo si ai pazari seancën që shkoi, që pasi u vendos gjoba 5 fish, u ul! Do t`ju ftoj të mos i hyni një prove force apo numrash, përsa kohë që këtë rradhë duhen 71 vota, se do të mpleksen shumë interesa në sallën e Parlamentit. Konfliktin jua thashë, s`e keni me ne.

**EDMOND SPAHO** - Saktësim në lidhje me atë që është cituar, që nga insistimi për t`u paguar detyrimi tatimor, do të falimentojë biznesi. Më duket abusive! S`di ndonjë rast, që biznesi të mos jetë në gjendje të paguajë detyrimet tatimor vjetor, për më tepër, që këtu bëhet fjalë për detyrim tatimor tre mujor, se paguhet me 4 këste gjatë vitit. Kur s`ka mundësi të paguajë, në legjislacionin fiskal është parashikuar të kërkojë pagesën me këste, në kohë. S`mendoj që ky argument qëndron.

**BLERIM CELA** - Më shumë po politizohet problemi, pasi biznesi s`është në rënie, po në zhvillim dhe vetë fakti që janë grumbulluar 350mln dollarë më shumë, tregon që ky biznes po prodhon, shet, fiton dhe paguan tatimet rregullisht. Ne s`e kemi konfliktin me biznesin, po politikisht me ju, se ju e keni pasur me 100% masën e pagimit, dhe me bizneset e parregullta. Atyre i themi stop! Paguj!

**ERJON BRAÇE** – Po abuzohet me shifra. Ma provo atë shifër!

**EDMOND SPAHO** - Plani i tatimeve dhe doganave është tejkeluar.

**ERJON BRAÇE** - 350mln dollarë më shumë? Do të vijë buxheti suplementar dhe do ta shohim!


**EDMOND SPAHO** - Vetë fakti që do të kemi buxhet shtesë, është tregues i tejkalimit.

**ERJON BRAÇE** – Është turp i madh me këto arsyetime!

**EDMOND SPAHO** – Nëse nuk ka diskutime e hedhin në votë.

6 kundër, 3 pro, nuk pranohet dekreti.

MBYLLET MBLEDHJA

Blerim Cela  
  
Sekretar

Mbajti procesverbalin:



Rudina Kiçi – Sekretare